

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6995
E enjte, 14 shtator 2023
Çmimi 0.40 €

Paralajmërimi i frikshëm
i Escobarit për masat
ndëshkuese ndaj Kosovës,
përmend NATO-n
dhe njohjet e reja **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI DHE PRESIDENTI I SERBISË, ALEKSANDËR VUÇIQ TAKOHEN SOT (E ENJTE) NË BRUKSEL ME NDËRMJETËSIMIN E BE-së **FAQE 4-5**

SOT RIFILLON DIALOGU, KURTI DHE VUÇIQI PËRBALLË NJËRI-TJETRIT



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq do të takohen sot (e enjte) në Bruksel në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga

BE-ja. Fillimisht, Kurti dhe Vuçiqi do të priten në takime të ndara nga dyshja e BE-së, Josep Borrell dhe Miroslav Lajçak, për të vazhduar më vonë me takimin trepalësh.

BE-ja ka njoftuar se takimi do të jetë i fokusuar në zbatimin e marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit, si dhe çështjet aktuale

'DIKUR RROTULLONIN XHIPA', LUSHI: EULEX-i PO TERRORIZON FAMILJET E HERONJVE. PSE PO HESHTIN KURTI DHE SVEÇLA?

FAQE 3



KMDLNJ-ja E AKUZON EULEX-in PËR MOSBESIM **FAQE 5**



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



KRYEMINISTRI KURTI: DO TA NDËRTOJMË STADIUMIN NACIONAL

F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Dhoma e Përfaqësuesve do të hapë hetim për gjykimin e Bidenit

WASHINGTON, 13 SHTATOR - Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy, ka bërë me dije se ka udhëzuar një komitet të Dhomës që të hapë zyrtarisht një hetim për gjykimin e presidentit Joe Biden lidhur me marrëveshjet biznesore të familjes së tij. Njoftimi për nisjen e procedurave, që në anglisht njihet si "impeachment", vjen para zgjedhjeve presidenciale të vitit 2024. McCarthy ka thënë se hetimi i Komitetit për Mbikëqyrje të Dhomës së Përfaqësuesve deri tani ka gjetur një "kulturë korrupsioni" përreth familjes Biden, përderisa republikanët po hetojnë marrëdhëniet se si ka bërë biznes djali i presidentit, Hunter Biden, para se Joe Biden ta merrte detyrën e presidentit. "Këto janë pretendime për

shpërdorim të pushtetit, pengim dhe korrupsion dhe ato kërkojnë një hetim të mëtejshëm nga Dhoma e Përfaqësuesve. Prandaj unë po e udhëzoj Komitetin e Dhomës për të hapur një hetim zyrtar për shkarkimin e presidentit Joe Biden", ka thënë McCarthy, republikan nga Kalifornia.

Njoftimi i bërë nga McCarthy vjen në kohën kur ai po përballet me presion në rritje nga krahu i djathtë i partisë së tij që të ndërmarë veprime ndaj Bidenit. McCarthy pritet të ketë disa takime gjatë kësaj jave me ligjvënësit, përfshirë edhe takime prapa dyerve të mbyllura për të diskutuar për shkarkimin e Bidenit.

Shtëpia e Bardhë e ka cilësuar njoftimin për nisjen e hetimit si proces të motivuar politikisht. "Kryetari McCarthy nuk duhej të



binte nën presionin e anëtarëve të së djathtës, të cilët po kërcënojnë me mbylljen e qeverisë nëse nuk nis gjykimin, pa prova, ndaj presidentit Biden. Pasojat për popullin amerikan janë shumë serioze", ka thënë zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë, Ian Sams.

Hapja e hetimit për gjykim ndaj Bidenit vjen në kohën kur ish-presidenti republikan Donald Trump, i cili dy herë është gjykuar, por u lirua nga akuzat nga Senati - po përballet me akuzat serioze në gjykata. Vetëm gjatë këtij viti Trumpi që, po ashtu, është kandidat për president, është përballur me katër akuzat. Ndër akuzat që rëndojnë ndaj Trumpit është edhe ajo se ai tentoi ta përmbyste rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2020 të cilat i ka fituar Bideni.

Kimi i premtonte Putinit mbështetje të plotë për "luftën e shenjtë" të Rusisë

MOSKË, 13 SHTATOR - Lideri i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, i ka thënë të mërkurën presidentit rus Vladimir Putin, se vendi i tij "e mbështet plotësisht dhe pa kushte luftën e shenjtë" të Rusisë për mbrojtjen e interesave të sigurisë së vet, duke iu referuar luftës në Ukrainë. "Peniani do të qëndrojë gjithmonë pranë Moskës në fronin anti-imperialist", tha Kim në Rusi më 13 shtator. Kimi, po ashtu, i ka quajtur marrëdhëniet në mes të Koresë së Veriut dhe Rusisë "prioriteti i parë". Dy liderët janë takuar në objektin e largët raketahedhës në Siberi, për të biseduar sesi interesat e tyre janë të përbashkëta përballë konfrontimeve të rritura dhe të ndara të vendeve të tyre me Shtetet e Bashkuara. Në fjalimin e tij hapës, Putini i ka uruar mirëseardhje Kimi në Rusi. Në mesin e çështjeve të diskutuara, Putini ka përmendur bashkëpunimin ekonomik, çështjet humanitare dhe "situatën në rajon". Takimi në mes të dy liderëve ka nisur në kozmodromin Vostochny, me një shëtitje rreth objektit raketahedhës të hapësirës, Soyuz-2, ku Kimi i ka bërë shumë pyetje rreth raketave një zyrtari



rus të hapësirës. Takimi ka ndodhur pak orë pasi Koreja e Veriut i ka lëshuar dy raketa balistike drejt detit, duke e vazhduar testimin provokator të armëve që nga fillimi i vitit 2022, pasi Kimi e ka përdorur shpërqendrimin nga lufta e Putinit në Ukrainë për ta përsheptuar zhvillimin e armëve. Shtabi i Përgjithshëm i Koresë së Jugut nuk ka treguar menjëherë se sa larg fluturuan raketat e Koresë së Veriut. Roja Bregdetare e Japonisë tha se raketat me gjasë kanë zbarkuar tashmë, por u bëri thirrje anijeve vëzhguese të shikojnë me kujdes për rënien e ndonjë objekti. Vendimi për t'u takuar në

kozmodrom, objektin më të rëndësishëm të Rusisë për lëshimin e satelitëve, lë të kuptohet se Kimi është duke kërkuar nga Rusia ndihmë teknike për të zhvilluar satelitë ushtarakë të zbulimit, të cilët i ka përshkruar si vendimtarë në rritjen e kërcënimit të tij me raketa bërthamore. Në muajt e fundit Koreja e Veriut ka dështuar vazhdimisht ta dërgojë në orbitë satelitin e vet të parë spiun. I pyetur nëse Rusia do ta ndihmojë Korenë e Veriut të ndërtojë satelit, Putini, sipas medieve ruse, ka thënë se "prandaj ne kemi ardhur këtu. Lideri i DPRK-së (Koresë së Veriut) ka shfaqur interesim të

madh në teknologjinë e raketave. Edhe ata po përpunohen ta zhvillojnë hapësirën. Ne do të bisedojmë për këto çështje pa nxitim. Kemi kohë", ka thënë Putini.

Putini e ka mirëpritur limuzinën e Kimi, e cila është sjell nga Peniani në trenin e veçantë të blinduar të liderit verikorean, në hyrje të kozmodromit. Ai ka thënë se ndihet "shumë i gëzuar" që e takoi Kimin. Përkthyesi i Kimi e ka falënderuar Putinin për mikpritjen e ngrohtë, "edhe pse i zënë". Për Putinin, takimi ishte një mundësi t'i rimbushur depot e municionit ta cilat i ka shterur lufta 18-mujore. Koreja e Veriut mund t'i ketë dhjetëra miliona raketa dhe predha të vjetruara bazuar në dizajnin sovjetik, të cilat mund ta forcojnë dukshëm ushtrinë ruse në Ukrainë, kanë thënë analistët. Kimi e mori me vete në Rusi Jo Chung Ryong, një zyrtar të partisë në pushtet i cili është përgjegjës për politikën e municionit.

Kimi ka thënë se vendimi i tij për ta vizituar Rusinë katër vjet pas vizitës së fundit, tregoi se Peniani po e bën "prioritet rëndësishëm strategjike" të marrëdhënieve me Moskën, tha të mërkurën

agjencia e lajmeve shtetërore e Koresë së Veriut.

Kimi pritet të kërkojë ndihmë ekonomike dhe të teknologjisë ushtarake. Marrëveshja për armë do të ishte në kundërshtim me sanksionet ndërkombëtare që Rusia i ka përkrahur në të kaluarën. Lim Soo-suk, zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Koresë së Jugut, ka thënë se Seuli po mban komunikim me Moskën, derisa po e vëzhgon nga afër vizitën e Kimi. "Asnjë shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara nuk duhet t'i shkelë sanksionet e Këshillit të Sigurimit ndaj Koresë së Veriut, duke u përfshirë në një shkëmbim të jashtëligjshëm të armëve, dhe natyrisht nuk duhet të angazhohet në bashkëpunim ushtarak me Korenë e Veriut, e cila minon paqen dhe stabilitetin e komunitetit ndërkombëtar", ka thënë Lim. Shtetet e Bashkuara e kanë akuzuar Korenë e Veriut se po i jep armë Rusisë, përfshirë shitjen e predhave të artilerisë grupit mercenar rus, Wagner. Zyrtarët rusë dhe verikoreanë i kanë mohuar këto akuzat. Thashethemet për bashkëpunim ushtarak u rritën pasi Sergei Shoigu, ministri i Mbrojtjes i Rusisë, e vizitoi Korenë e Veriut në korrik.

Rusët hapin 7 mijë biznese në Serbi që nga fillimi i luftës në Ukrainë

Beograd, 13 shtator - Që nga fillimi i luftës në Ukrainë, në Serbi janë hapur gati 7 mijë biznese nga qytetarë rusë. Pra, sipas Qendrës për Studime

Evropiane (CEP), 7 mijë kompani ruse janë hapur në Serbi. Sidoqoftë, raporti i CEP ka theksuar se përkundër këtij numri kaq të madh, nuk dihet nëse të

gjitha këto kompani do të kontribuojnë në rritjen ekonomike të Serbisë. "Gjenerata e re e emigrantëve rusë përbëhet nga të rinj sipërmarrës nga

klasa e mesme dhe e lartë e mesme, të punësuar në sektorin e IT-së dhe që punojnë në distancë", është thënë në raportin e CEP-it, raporton "Nova".



KMDLNj-ja e akuzon EULEX-in për mosbesim



PRISHTINË, 13 SHTATOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut ka reaguar rreth rastit të bastisjes së banesës së familjarëve të heronjve Fahri dhe Bahri Fazliu në Prishtinë dhe për ndalimin e Rustem Mustafës - "Remit" me kërkesë të Gjykatës Speciale. Ky këshill përmes një reagimi ka thënë se këto ngjarje po sjellin një shqetësim të madh për drejtësinë dhe sovranitetin e Kosovës.

"EULEX-i doli me një sqarim se ata nuk kanë marrë pjesë në bastisje e as në arrestim në ndërkohë që intervistimet dhe të arrestuarit dërgohen në bazën e EULEX-it", është thënë në reagim.

Më tutje KMDLNj e ka akuzuar EULEX-in për mosbesim ndaj Policisë së Kosovës.

"Edhe të arrestuarit apo të dënuarit e Gjykatës Raciste të Hagës gjatë vizitave humanitare në Kosovë pjesën më të madhe të kohës e kalojnë në njësinë e paraburgimit në bazën e EULEX-it që nënkupton se aspak nuk i besojnë Policisë së Kosovës, madje e shpërfillin dhe e nënçmojnë profesionalizmin e

saj sikur që ishte me rastin e ofrimin e garancioneve për mbikëqyrje dhe zbatim të masave alternative nëse eventualisht masa e paraburgimit i zëvendësohet ndonjëherë nga të burgosurit me ndonjë masë më të butë", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Në këtë reagim është theksuar se "nuk ndodh në një vend normal që persona të pidentifikuar, në çdo kohë dhe kur të duan, pa dijen e autoriteteve vendore të arrestojnë, intervistojnë shtetasit tuaj e që nuk ka ndodhur as në diktaturat më brutale".

Banesa e familjarëve të heronjve Fazliu është bastisur të martën në mëngjes. Sipas familjarëve, janë marrë disa materiale, fotografi, libra, ndërsa pak orë më vonë është ndaluar edhe Rustem Mustafa, të cilit i është konfiskuar telefoni. Po ashtu, gazeta "Epoka e re" ka raportuar edhe për ndalimin e ish-ambasadorit të Kosovës në Tiranë, Nait Hasani, të cilit, po ashtu, i është konfiskuar telefoni nga EULEX-i.

ME URDHËR TË GJYKATËS SPECIALES NDALOHET NAIT HASANI

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Ish-i burgosuri politik dhe ish-ambasadori i Kosovës në Shqipëri, Nait Hasani, të dielën rreth orës 14:30 është shoqëruar nga hetuesit e EULEX-it për tri orë në bazën e tyre në Fushë-Kosovë.

Sipas burimeve të "Epokës së re", shoqërimi i tij është bërë për kontrollimin dhe konfiskimin e telefonit me urdhër të Gjykatës Speciale në Hagë.

Këto informacione janë konfirmuar nga vetë Hasani, i cili

ka pohuar se Policia e EULEX-it e ka ndaluar dhe për tri orë rresht është mbajtur në bazën e tyre në Fushë-Kosovë. Hasani ka pohuar se me urdhër të Dhomave të Specializuara i është konfiskuar telefoni personal.



"Dikur rrotullonin xhipa", Lushi: EULEX-i po terrorizon familjet e heronjve. Pse po heshtin Kurti dhe Sveçla?



PRISHTINË, 13 SHTATOR - Veprimtari i njohur i cili jeton në Amerikë, Uk Lushi, i ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti dhe ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, për mosreagim ndaj bastisjeve të fundit të EULEX-it me urdhër të Gjykatës Speciale. Ai ka shkruar në "Facebook" se dikur Kurti dhe Sveçla i rrokullisnin xhipat e EULEX-it, ndërsa sot heshtin në raport me këtë mision. Ai ka shprehur habi për heshtjen e tyre ndaj veprimeve të fundit të EULEX-it, i cili ka bastisur qytetarë dhe familje heronjsh. "Si është e

mundur që Albin Kurti dhe Xhelal Sveçla dikur rrotullonin xhipat e EULEX-it dhe me të drejtë kërkonin që shteti i Kosovës të jetë sovran në monopolin policor dhe ligjor, kurse tash, ndërsa janë në pushtet kjo dyshe trimash, EULEX-i terrorizon qytetarë dhe familje heronjsh të Kosovës me bastisje si dikur milicia serbe, megjithatë Kurti dhe Sveçla nuk bëjnë?! Çka ka ndodhur me ju dhe azganët e LV-së? Deri kur nuk do të guxoni të flisni dhe veproni si qeveri, pushtet dhe shtet?!", ka shkruar Lushi.



KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI DHE PRESIDENTI I SERBISË, ALEKSANDËR VUÇIQ TAKOHEN SOT (E ENJTE) NË BRUKSEL ME NDËRMJETËSIMIN E BE-së

Sot rifillon dialogu, Kurti dhe Vuçiqi përballë njëri-tjetrit

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq do të takohen sot (e enjte) në Bruksel në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja. Fillimisht, Kurti dhe Vuçiqi do të priten në takime të ndara nga dyshja e BE-së, Josep Borrell dhe Miroslav Lajçak, për të vazhduar më vonë me takimin trepalësh. BE-ja ka njoftuar se takimi do të jetë i fokusuar në zbatimin e marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit, si dhe çështjet aktuale

EPOKA E RE

Lirim GEÇI

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Bashkimi Evropian (BE) ka njoftuar se takimet e diplomatëve evropianë me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin serb, Aleksandër Vuçiq do të nisin sot (e enjte) qysh prej orës 09:00.

Fillimisht, diplomatët do të takohen ndaras me liderët e dy vendeve, e më vonë pritet të mbahet një takim trepalësh në mes të Kurtit, Vuçiqit dhe kryediplomatit të BE-së, Josep Borell, i cili do të shoqërohet nga i dërguari i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak.

Në këtë takim pritet të diskutohet për zbatimin e marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve, të arritur në shkurt të këtij viti dhe më pas për çështjet aktuale.

Takimi i sotëm në mes të Kurtit dhe Vuçiqit është i pari prej kur janë rritur tensionet në veri të Kosovës.

Tensionet janë rritur pasi banorët serbë në këto komuna nuk i kanë pranuar kryetarët e rinj shqiptarë – të dalë nga zgjedhjet që ata i kanë bojkotuar – dhe e kanë refuzuar hyrjen e kryetarëve nëpër ndërtesa komunale. Situata me raste është përshkallëzuar në dhunë. Në takimin e sotëm pritet të diskutohet për këto tensione dhe gjetjen e rrugës për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në katër komuna në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe – Mitrovicë e Veriut, Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok.

Hera e fundit kur dy liderët janë takuar në Bruksel, në kuadër të dialogut, ka qenë 2 maji i këtij viti. Pata këtij takimi, kryeministri Albin Kurti ka thënë se ka biseduar me të dërguarin amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. “Kryeministri Kurti shprehu gatishmërinë e tij për t’u angazhuar aktivisht në takimin e nivelit të lartë politik

të së enjtes në Bruksel, teksa falënderoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme për Kosovën”, ka njoftuar zyra e kryeministrit. Përkushtim në dialog ka kërkuar edhe Gjermania.

Ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, ka thënë më 11 shtator se runda e dialogut zhvillohet në një “moment kritik”. “Na duhet përkushtimi i plotë i të dyja palëve për shtensionim të plotë, për dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja dhe për një demokraci pjesëmarrëse. Marrëveshja e Ohrit duhet të zbatohet tani. Nuk duhet të ketë më lojëra për të fajësuar të tjerët. Hiqni pengesat për përparim. Është koha të veprohet në të mirë të të gjithëve”, ka shkruar ai në “X”, që më herët njihej si “Twitter”.

Kosova dhe Serbia kanë arritur pajtueshmëri në shkurt për atë që njihet si marrëveshje drejt normalizimit të marrëdhënieve me dy vendeve.

Më pas, në mars në Ohër, palët janë pajtuar për aneksin e zbatimit të marrëveshjes bazë. Marrëveshja prej 11 nenesh nuk përfshin njohjen reciproke për të cilën insiston Kosova, por kërkon nga Kosova dhe Serbia që t’i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë: pasaportat, diplomatat dhe targat.

Në BE pranojnë se nuk ka pasur përparim drejt zbatimit të Marrëveshjes dhe as aneksit të saj, andaj pritet që fokusi të enjten të jetë në kthimin e dialogut në fazën e zbatimit të obligimeve që kanë marrë dy vendet.

Kosova dhe Serbia janë pjesë e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja, për normalizim të raporteve, prej vitit 2011. Palët kanë nënshkruar një mori marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar.

Rama: Taktikat vetëdëmtuese të Kosovës po e ndihmojnë viktimizimin e Serbisë

Një ditë para takimit të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq në Bruksel, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se shpreson që ai të mos jetë një xhiro bosh. Ai ka thënë se Kosova ka bërë

një hap të konsiderueshëm në drejtimin e shumëpritur duke pranuar planin franko-gjerman dhe tani është koha që edhe Serbia të dalë nga llogorja e absurdit të mohimit të realitetit dhe të veprojë në mirëbesim, duke mundësuar një sekuencë zbatimi që i përmbush nevojat e të dyja palëve në kuadër të planit franko-gjerman. “Por më duhet ta ritheksoj, se sa më lart nuk do të thotë aspak se Shqipëria e sheh Kosovën si të vetmen përgjegjëse për futjen e dialogut në qorrsoak. Assesi jo. Kosova bëri një hap të konsiderueshëm në drejtimin e shumëpritur, duke e pranuar planin franko-gjerman pa referencë për njohjen reciproke dhe duke pranuar po ashtu, propozimin e vetë-menaxhimit për komunitetin serb. E kam duartrokatur menjëherë Albin Kurtin për këtë hap edhe publikisht, jo vetëm personalisht. Tani është koha që edhe Serbia të dalë nga llogorja e absurdit të mohimit të realitetit dhe të veprojë në mirëbesim, duke mundësuar një sekuencë zbatimi që i përmbush nevojat e të dyja palëve në kuadër të planit franko-gjerman”, ka thënë Rama.

Më tutje, ai ka thënë se “dyshoj se strategjia e Beogradit është të vonojë procesin dhe të përfitojë sa më shumë nga taktikat vetëdëmtuese të Prishtinës, të

Krasniqi mbron udhëzimin administrativ për largimin e kryetarëve të veriut

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka folur të mërkurën për disa tema, përfshirë organizimin e zgjedhjeve në katër komunat në veri të Kosovës, një kërkesë e kamotshme e ndërkombehtarëve. Në fakt, Krasniqi ka dhënë disa detaje në lidhje me udhëzimin administrativ që është publikuar kohë më parë dhe i cili i hap rrugën shkarkimit të katër kryetarëve në veri të Kosovës. Në konferencë Krasniqi ka thënë se udhëzimi administrativ bazohet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, duke shtuar se në lidhje me këtë temë ka pasur edhe takime me Quintin. "Neni 72 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale është baza ku është bazuar edhe udhëzimi administrativ. Në këtë udhëzim administrativ kanë punuar ekspertët më të mirë të MAPL-së. Kemi pasur edhe një mbështetje edhe me ekspertë

edhe me koordinim të vazhdueshëm me gjithë aktorët e rëndësishëm. Këtu kemi pasur edhe takime me përfaqësues të ambasadave të Quintit", ka thënë Krasniqi. Më tutje, ai ka vlerësuar se udhëzimi administrativ është një instrument demokratik për nisjen e hapave ligjorë për largimin e kryetarëve nga posti i tyre. "Produkti që e kemi para vetes është instrumenti i vetëm demokratik - inicimi i kërkesës së qytetarëve për largimin e kryetarëve nga zyrat për shkak se ka qenë i vetëm institucion kryetari i komunës, i cili nuk është paraparë, edhe forma se si mund të largohet, përveç zgjedhjes së drejtpërdrejtë dhe dhënies së dorëheqjes. Kështu që tash një kryetar i komunës me votën e njëjtë që zgjidhet, mund të largohet", ka thënë ai. Në këtë konferencë Krasniqi është pyetur nëse ka rrezik që ky udhëzim të shpallet



antikushtetues. Në këtë kontekst ai ka thënë se nuk dëshiron të flasë për rreziqet. "Unë nuk mund të flas për rreziqet. Nuk dua të flas për rreziqet. Unë po flas për një proces demokratik. Ne si ministri përgjegjëse për

administrimin e pushtetit lokal kemi marrë një detyrë. Detyra ka qenë që të prodhohet një udhëzim administrativ, i cili e proceson kërkesën e qytetarëve për shkak se është e drejtë e qytetarëve edhe inicimi i

peticionit për largimin e kryetarit të komunës nga zyra", është shprehur Krasniqi. Më tutje, ai ka thënë se udhëzimi administrativ është përmbushje e obligimeve që rrjedhin nga marrëveshja e Bratislavës, për të cilën janë pajtuar zëvendëskryeministri Besnik Bislimi dhe Miroslav Lajçakut, emisar special i BE-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Si qeveri e Republikës së Kosovës kemi pasur një angazhim të theksuar në mënyrë që ky udhëzim administrativ të kryhet në afate shumë të shpejta si përgjigje e marrëveshjes së Bratislavës. Që prej fillimit kemi thënë se jemi të interesuar për zgjedhje të parakohshme, se kryetarët e zgjedhur nuk janë kryetarë me K të madhe, mirëpo prapëseprapë këta janë kryetarë legjitimë për shkak se kanë prodhuar një proces zgjedhor", ka thënë Krasniqi.

Paralajmërimi i frikshëm i Escobarit për masat ndëshkuese ndaj Kosovës, përmend NATO-n dhe njohjet e reja

WASHINGTON, 13 SHTATOR - Zëvendësdihmëssekretari amerikan i Shtetit, Gabriel Escobar, në një intervistë për "Zërin e Amerikës" ka bërë paralajmërim të frikshme nëse Kosova dhe Serbia nuk shënojnë përparim në kuadër të dialogut. Escobar ka përmendur si masa ndëshkuese ndaj Kosovës çështjen e njohjeve të reja, konferencë donatorësh, dialogun strategjik me ShBA-në dhe marrëdhëniet më të afërta me NATO-n. "Tashmë po fillojmë t'i shohim pasojat. Megjithëse Kosova i quan sanksione, ato nuk janë vërtet sanksione - masat që BE-ja ka vendosur, për të mos vazhduar me disa nga mekanizmat e anëtarësimit, janë mjaft serioze. Edhe për Serbinë do të jetë po kështu. Por, për Kosovën - mundësitë për njohje të reja, për konferencë donatorësh, për dialog strategjik dypalësh me Shtetet e Bashkuara dhe për një marrëdhënie të afërt me NATO-n. Fatkeqësisht, nëse nuk shënojmë

përparim, do ta humbim këtë (mundësi) këtë vit. Edhe për Serbinë do të jetë shumë e ngjashme. Bashkimi Evropian do të dëshirojë të shohë shenja më të qarta nga Serbia se është e interesuar ta zbatojë këtë marrëveshje të normalizimit, ndërkohë që vendos për përparimin e Serbisë në rrugën e saj drejt integritetit", ka thënë Escobar. Pavarësisht prej kësaj, Escobar ka thënë se pret nga Kosova dhe Serbia t'i marrin seriozisht detyrimet e tyre të dala nga marrëveshja gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve dhe të fillojnë përmbushjen e tyre për të shënuar përparim në zbatimin e saj. "Do të donim t'u kërkonim palëve t'i marrin seriozisht detyrimet e tyre nga kjo marrëveshje dhe të fillojnë të përparojnë për përmbushjen e detyrimeve ekzistuese dhe të mëparshme nga dialogu dhe nga marrëveshja dhe të fillojnë të shënojnë përparim këtë vit", ka thënë Escobar.



cilat e kanë ndihmuar vijimësisht viktimizimin e Serbisë ne arenën e ndërkombehtarë". "Shqipëria i ka shtrirë Serbisë dorën e miqësisë. Në mënyrë ironike, ka ndodhur në ndonjë rast të jemi i vetmi vend në rajon që ka folur hapur kundër sanksioneve ndaj Serbisë dhe e kemi shpjeguar qartë pse jemi të bindur në këtë qëndrim. Megjithatë, dhe kjo duhet theksuar, një përfundim i suksesshëm. Për fat të keq, teksa përpiqem pa sukses të kuptoj taktikat e qeverisë së Kosovës, mbetem po aq i pasuksesshëm në përpjekjen për të kuptuar strategjinë e dialogut të Serbisë. Dyshoj se strategjia e Beogradit

është të vonojë procesin dhe të përfitojë sa më shumë nga taktikat vetëdëmtuese të Prishtinës, të cilat e kanë ndihmuar vijimësisht viktimizimin e Serbisë ne arenën e ndërkombehtarë", ka thënë Rama duke shtuar se Shqipëria është për paqe, pajtim, ardhmëri të përbashkët, por sipas tij, nëse gjërat shkojnë keq, Shqipëria dhe shqiptarët janë me Kosovën. "Fatkeqësisht po ashtu, disa harrojnë se nuk jemi më në vitet '90 të shekullit të kaluar. Shqipëria është për paqe, pajtim, ardhmëri të përbashkët dhe pikë. Por megjithatë, nëse gjërat shkojnë keq, Shqipëria

dhe shqiptarët janë me Kosovën, e këtë s'e luan topi. Thënë kjo, unë me sinqeritet shpresoj që të gjithë të përfshirët në procesin e normalizimit të jenë të vetëdijshëm për atë çfarë luhet sot mes Kosovës e Serbisë dhe të kuptojnë drejtë e mori, që çdo alternativë tjetër, përveç zbatimit të menjëhershëm, gjithëpërfshirës, të marrëveshjes mbi planin franko-gjerman në rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë është lojë me zjarrin, ku kush luan do të digjet i pari, po akoma më keq, në fund do të përvëlohet krejt rajoni, po nuk do të shpëtojë pa u përcëlluar edhe vetë Evropa. Përfundimi i

suksesshëm i procesit të normalizimit të Kosovës e Serbisë janë parësore për paqen dhe sigurinë rajonale, po edhe për sigurinë e vetë Evropës", ka thënë Rama.

Hoti: Në Bruksel do të diskutohet për zbatimin e marrëveshjes të arritur në villat e Titos

Ish-kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se për takimin e nivelit të lartë në Bruksel nuk mund të kemi pritje jorealiste. Ai ka thënë se në këtë takim do të diskutohet për zbatimin e "Marrëveshjes së

arritur në villat e Titos në Ohër". Hoti ka thënë se nuk mund të pritjet për negociim të njohjes reciproke, pasi sipas tij kryeministri Kurti ka hequr dorë nga kjo. "Të jemi të qartë e të mos kemi pritje jorealiste për takimin e nesërm për dialog në Bruksel: Nesërm negociohet vetëm për zbatimin e marrëveshjes së arritur në villat e Titos në Ohër. Nuk negociohet për njohje reciproke, pasi Kosova ka hequr dorë nga njohja reciproke si kompromis për të arritur marrëveshjen e Ohrit. Bërjen e këtij kompromisi e dëshmoi vetë kryenegociatori i Kosovës para disa dite në medie të huaja", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Qeveria zvicerane ndihmon 91 fermerë të Rahovecit që u dëmtuan nga vërshimet

RAHOVEC, 13 SHTATOR - Organizata për Ushqim dhe Bujqësi (Food and Agriculture Organization - FAO), financuar nga Qeveria e Zvicrës, këtë vit do t'i ndihmojë fermerët e Rahovecit të cilët janë prekur nga vërshimet e muajit janar të këtij viti.

Organizata FAO do të shpërndajë kuponë me një shumë simbolike për 91 fermerë të cilët do t'i shfrytëzojnë për kompensim nga dëmet sipas nevojave të tyre për produkte bujqësore.

Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se kjo komunë nuk ka mundësi t'i mbulojë dëmet bujqësore për shkak se nuk ka fonde të mjaftueshme.

Latifi e ka falënderuar organizatën FAO dhe qeverinë zvicerane për këtë mbështetje, të cilën e ka konsideruar ndihmesë të nevojshme për fermerët e Rahovecit. Po ashtu, ai ka thënë se janë të gatshëm ta vazhdojnë bashkëpunimin me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe

Bujqësi (FAO).

Ndërsa zëvendës drejtori për bashkëpunim nga Zyra e Zvicrës, Laurent Torche, ka thënë se përmes kësaj ndihme për bujqit në komunën e Rahovecit dëshiron të sigurojë mirëqenie dhe kapacitet të produkteve bujqësore.

Torche ka thënë se Zyra e Zvicrës ka një bashkëpunim të shkëlqyer me Qeverinë e Kosovës. Ai ka theksuar se do të vazhdojnë ta mbështesin Kosovën edhe në vitet në vazhdim.



Bedri Krasniqi lirohet nga akuza për vrasjen e dy policëve në Podujevë, Alban Dezdari dënohet me 8 vjet burgim



PRISHTINË, 13 SHTATOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykim lirues ndaj Bedri Krasniqit lidhur me akuzën për vrasjen e dy zyrtarëve policorë në vitin 2004 në Podujevë, kurse Alban Dezdari është dënuar me tetë vjet burgim për veprën penale "Ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje". Aktgjykimi ndaj dy të akuzuarve është shpallur të mërkurën nga kryetari i trupit gjykues, Arben Hoti. Sipas aktgjyimit, nuk është provuar se Krasniqi ka kryer veprën penale që i vihej në barrë. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të gjykatës. Kurse Alban Dezdari është shpallur fajtor duke u dënuar

me tetë vjet burgim për veprën penale "Ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje", kurse është liruar nga akuza për "Vrasje të rëndë e mbetur në tentativë". Atij do t'i llogaritet në dënim edhe koha e kaluar në paraburgim.

Të akuzuar në këtë rast për vrasjen e zyrtarëve policorë kishin qenë edhe Bajram Kiqmari dhe Faik Shaqiri, mirëpo Gjykata Supreme në shtator 2017 kishte nxjerrë aktvendim për lirimin e tyre pasi, sipas kësaj gjykate, dy të akuzuarit ishin gjykuar vite më parë rreth kësaj ngjarjeje dhe se ekziston një aktgjykim për pushimin e hetimeve kundër tyre.

Haxhiu insiston se Kodi Civil do të votohet këtë vit

Prishtinë, 13 shtator - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije se Kodi Civil do të procedohet për votim në Kuvend këtë vit. Ajo ka sqaruar se këtë vit në Kosovë për vizitë do të qëndrojë një delegacion i Këshillit të Evropës, duke shtuar se institucionet duhet të dëshmojnë se janë për avancimin e të drejtave të njeriut. Madje Haxhiu i ka ftuar deputetët e pozitës dhe opozitës ta votojnë këtë dokument, duke shtuar se për këtë çështje kanë diskutuar me bashkëpartiakët që janë kundër.

"Unë kam thënë që brenda këtij viti do të procedohet Kodi Civil. Konsideroj se është një dokument shumë i

rëndësishëm dhe sidomos duke pasur parasysh që delegacioni nga Këshilli i Evropës do të vijë në Kosovë gjatë këtij viti, është mirë që Kosova të dëshmojë si vend që është për avancimin e të drejtave të njeriut", ka thënë Haxhiu, duke shtuar se Kodi Civil duhet të miratohet nga deputetët. "Unë mendoj se do të duhej të kaloj, nuk besoj se Kosova do të ishte një shembull i mirë në qoftë se për herë të dytë rrezohet një dokument siç është Kodi Civil, prandaj duke pasur parasysh këtë çështje, uroj deputetët e grupit parlamentar të Vetëvendosjes dhe të opozitës, sepse edhe ata njësoj e kanë për obligim ta mbështetin të njëjtin", ka thënë Haxhiu.




Qeveria ndan 500 mijë euro për të prekurit nga tërmeti në Turqi

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Qeveria e Kosovës ka ndarë 500 mijë euro për t'i ndihmuar familjet e prekura nga tërmeti

shkatërrues që kishte goditur Turqinë në fillim të këtij viti. Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se këto

mjete vijnë si mbështetje për qytetarët në Turqi që kanë pësuar nga tërmeti. Kujtojmë se më 6 shkurt të këtij viti

Turqia ishte goditur nga një tërmet shkatërrues, si pasojë e të cilit mbi 50 mijë persona kanë humbur jetën.



Von der Leyen: E ardhmja e Ballkanit Perëndimor dhe Ukrainës është në BE



BRUKSEL, 13 SHTATOR - Presidentja e Komisionit Evropian (KE), Ursula von der Leyen, ka thënë të mërkurën se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor dhe e Ukrainës është në Bashkimin Evropian (BE). Në një fjalim vjetor për gjendjen e BE-së para deputetëve të Parlamentit Evropian në Strasburg, Von der Leyen ka thënë se unioni “nuk mund t’i lërë vetëm bashkëkombësit tanë”. “E ardhmja e Ukrainës është në unionin tonë. E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në BE. E ardhmja e Moldavisë është në BE. Dhe e di se sa e rëndësishme është perspektiva evropiane edhe për shumë njerëz në Gjeorgji”, ka thënë Von der Leyen. Fjalimi për “Gjendjen në Union” është momenti më i rëndësishëm vjetor për BE-në.

Është fjalimi i përgjithshëm vjetor i presidentit të Komisionit Evropian në seancën plenare të Parlamentit Evropian dhe mbahet rregullisht në shtator. Fjalimi përfshin veprime që Komisioni Evropian synon të ndërmarë përmes legjislacionit dhe nismave të tjera deri në fund të vitit të ardhshëm. Von der Leyen ka thënë se “Evropa përgjigjet ndaj thirrjeve historike. Historia na fton ta përmbyllim ndërtimin e unionit tonë. Në botën ku disa tentojnë t’i nënshtrojnë vendet një nga një, ne nuk mund t’i lëmë vetëm bashkëkombësit tanë evropianë. Në botën ku madhësia dhe pesha janë të rëndësishme, përmbyllja e unionit tonë, padyshim, është interes strategjik i BE-së”. Ajo e ka përmendur rajonin e Ballkanit edhe kur ka folur për

bashkëpunimin në menaxhimin e migrimit ilegal. “Pakti për migrim i BE-së ka siguruar një baraspeshë mes të drejtave të njeriut dhe ruajtjes së kufijve, mes sovranitetit dhe solidaritetit, mes sigurisë dhe njerëzisë. Kemi bashkëpunuar ngushtë me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe kemi zvogëluar valët ilegale të migrimit”, ka thënë ajo. Në gusht, edhe presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, ka bërë thirrje që viti 2030 të caktohet si afati deri kur Bashkimi Evropian dhe vendet kandidatë të jenë të gatshëm për zgjerim gjatë Forumit Strategjik të Bledit. Vendeve të Ballkanit Perëndimor u është premtuar perspektivë evropiane prej vitit 2003 në një samit në Selanik. Nga ajo kohë, vetëm Kroacia nga vendet e rajonit është anëtarësuar në BE

në vitin 2013. Negociatat për anëtarësim ka vite që i kanë nisur Mali i Zi dhe Serbia, ndërsa në korrik të vitit 2022 i kanë nisur edhe Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Bosnjë-Hercegovina e ka marrë statusin e vendit kandidat në dhjetor të vitit të kaluar, ndërsa Kosova ka vetëm Marrëveshje Stabilizim-Asociimi (MSA) me BE-në.

“Një vizion për sukses”

Von der Leyen ka bërë thirrje për një vizion për zgjerimin e suksesshëm të BE-së. “...Një union i plotësuar, ku më shumë se 500 milionë njerëz jetojnë në liri, demokraci dhe prosperitet. Një union i plotësuar ku të rinjtë mund të jetojnë dhe studiojnë në liri. Union në të cilin ka demokraci, ku gjykatat janë të

pavarura, ku opozita respektohet dhe gazetarët mbrohen. Këto do të jenë themelet e unionit tonë në vendet e tashme dhe të ardhme anëtare”, ka thënë ajo.

Ajo ka rikujtuar se para 20 vjetëve, kur kishte ndodhur zgjerimi i madh, e kishin quajtur këtë si “dita e mirëseardhjes” dhe prej atëherë ato vende kanë shënuar “përparim të madh në secilin aspekt.”

“BE-ja me më shumë se 30 anëtarë”

Megjithatë, ajo përsëriti se Komisioni Evropian do ta ruajë gjithmonë parimin e meritave individuale në procesin e reformave gjatë procesit të zgjerimit.

Von der Leyen, po ashtu, ka bërë thirrje të tejkalohen debatet e vjetra që krijojnë dilema mes reformave të brendshme dhe zgjerimit sepse, sipas saj, është dëshmuar se këto dy gjëra mund të shkojnë paralelisht. “Nuk mund t’i presim ndryshimet e traktateve për t’u zgjeruar. Kjo duhet të ndodhë më shpejt, duhet të gjejmë përgjigje në pyetjen se si do të funksionojë BE-ja me më shumë se 30 anëtarë”, ka thënë ajo, duke rikujtuar se me 27 vende anëtare BE-ja ka dëshmuar se mund të funksionojë.

Von der Leyen ka përsëritur disa herë mbështetjen për Ukrainën, e cila është duke u përballur me pushtimin e jashtëligjshëm nga Rusia tash e 18 muaj. “Do të jemi me Ukrainën deri në fund. Mbi katër milionë ukrainas kanë gjetur strehim në BE. Do të jenë të mirëpritur dhe dyert tona për ta do të jenë të hapura”, ka nënvizuar ajo.

Ajo ka thënë se bashkë me anëtarët e tjerë të Komisionit Evropian i kanë përmbyllur mbi 90 për qind të synimeve që i kishte shprehur në fillim të mandatit në vitin 2019. Ky ishte fjalimi i saj i fundit për gjendjen e BE-së, por edhe fillimi indirekt i fushatës së saj parazgjedhore. Përkatesisht, në qershor të vitit të ardhshëm do të mbahen zgjedhjet evropiane, të cilat do të rezultojnë me një strukturë të re në të gjitha institucionet evropiane.

Osmani e njofton komandantin në ardhje të KFOR-it për sfidat e sigurisë në veri

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Në prag të marrjes së detyrës të komandantit të ri të KFOR-it, presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim gjeneralmajor Ozkan Ulutas, shoqëruar nga komandanti aktual, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia. Me këtë rast, presidentja Osmani ka shprehur besimin e plotë për bashkëpunim të

ngushtë me gjeneral Ulutas gjatë udhëheqjes së tij të KFOR-it për përbashkëtimin e synimeve të përbashkëta për paqe dhe siguri në Kosovë dhe rajon. Po ashtu, gjatë takimit presidentja Osmani ka theksuar nevojën për rritjen dhe thellimin e bashkëpunimit në mes të KFOR-it dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, në funksion të menaxhimit efektiv të sfidave të mjedisit

të sigurisë rajonale dhe më gjerë. Ajo e ka njoftuar komandantin në ardhje të KFOR-it për këto sfida të sigurisë, të cilat në veri të vendit shkaktohen për shkak të strukturave ilegale të dirigjuara nga Serbia, të cilat i kanë udhëhequr sulmet ndaj pjesëtarëve të KFOR-it më 29 maj si dhe sulmet e njëpasnjëshme ndaj Policisë së Kosovës dhe gazetarëve.



Të papunët do të punësohen në procesin e regjistrimit të popullsisë

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Propozim-vendimi i Ministrisë së Financave për shtimin e një mase të re në kuadër të masave për mbështetjen e punësimit është miratuar të mërkurën nga Qeveria e Kosovës. Bazuar në propozimin e ministrit Hekuran Murati, personat e papunë do të kenë mundësi të angazhohen si punonjës në

procesin e regjistrimit të popullsisë që pritet të nisë këtë vit. Murati ka thënë se personat e papunë do të kenë përparësi në këtë proces punësimi të përkohshëm. "Pika e radhës e rendit të ditës ka të bëjë me shtimin e një mase të re në kuadër të masave për mbështetjen e punësimit në ofrimin e shërbimeve publike dhe synimi është që

përgjatë procesit të regjistrimit të mundësojmë punësimin e personave të papunë dhe t'i angazhojmë në procesin e regjistrimit. Pra, sadopak, personat që janë të papunë në Republikën e Kosovës të angazhohen qoftë edhe përkohësisht, në mënyrë që të ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve publike dhe të angazhohen", ka thënë ministri Murati.



Perimet për turshi, "të paprekshme"

PRISHTINË, 13 SHTATOR - "Për mua janë të paprekshme. Duhet t'i lë të gjitha", ka thënë Sali Aliu teksa shikonte çmimet e perimeve në Tregun e Gjellbër në Prishtinë.

"Çka të bëj?", ka pyetur pensionisti nga Podujeva, i cili merr rreth 200 euro në muaj. Në këtë periudhë të vitit qytetarët e Kosovës zakonisht furnizohen me perime për turshi, por çmimet e tyre sivjet i kanë befasuar shumë prej tyre. "Vitin e kaluar nëse i ke marrë specat me thes (3 kilogramë) kanë kushtuar prej 1.5 deri në 1.8 euro. Sivjet 3 euro e gjysmë është thesi i njëjtë, me kilogramë të njëjtë. Domatet vjet i kemi marrë 60 deri në 70 centë për kilogram. Sivjet i ke 1.2 deri në 1.5 euro", ka thënë Amir Simnica nga Prishtina.

Ndërsa bashkëqytetarja e tij, Mirishahe Stublla, ka thënë se vitin e kaluar ka siguruar dhjetë thasë me specat, domate, tranjug, hudhër, majdanoz e të tjera për 30 euro. Me këto para, ajo ka thënë se sivjet nuk arrin ta marrë as gjysmën e këtyre furnizimeve. Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", Visar Hajdari, i cili shet produkte të ndryshme bimore në tezgë, ka bërë disa krahasime. "Pasuli vitin e kaluar ka qenë 2.5 deri në 4 euro, ndërsa sivjet është 4 euro për kilogram. Hudhra vitin e kaluar ka qenë 5 euro, sivjet është 6 euro. Mjaliti vjet ka qenë 8 euro, sivjet është 15 euro. Mielli i misrit vjet ka qenë 80 centë, sivjet është 1.3 euro", ka thënë ai.

Rritjen e çmimeve e kanë konfirmuar zyrtarisht edhe të



dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Ato tregojnë se çmimi i perimeve në gusht të këtij viti është rritur për 28 për qind krahasuar me gushtin e vitit të kaluar, ndërsa çmimi i pemëve është rritur për 11.4 për qind. Buka dhe drithërat janë shtrenjtuar për 4.5 për qind, mishi për 3.8 për qind, ndërsa qumështi, djathi dhe vezët për 2.4 për qind. Për shkak të pandemisë së koronavirusit dhe pushtimit rus të Ukrainës, çmimet gjetu në botë janë rritur, sidomos më 2021 dhe 2022, për të hyrë pastaj në një trend të stabilizimit. Vitin e kaluar Kosova e ka përmbyllur me normë mesatare të inflacionit gati 12 për qind.

Pse ky shtrenjtim i pemëve dhe perimeve?

Tahir Tahiri, udhëheqës i Federatës Sindikale të Bujqve të Kosovës, thotë se rendimentet e ulëta nga

prodhuesit vendorë kanë ndikuar në ngritjen e çmimeve të produkteve bujqësore, sidomos të perimeve dhe pemëve. E në uljen e rendimenteve, thotë ai, ka ndikuar vonesa e mbjelljes dhe kultivimit për shkak të shirave gjatë gjithë muajve të pranverës. "Bujqit e shfrytëzojnë shansin për t'i ngritur çmimet jo vetëm pse ka prodhimtari të paktë dhe rendimentet të ulëta, por edhe për shkak të kostos së prodhimit. Në kushte të vështira klimatike duhet të investohet më shumë. Kostoja e prodhimit është rritur, sepse duhet të merren masa mbrojtëse. Pra, kostoja e prodhimit është e ka kushtëzuar bujkun që t'i ngritë çmimet e këtyre produkteve bujqësore", ka thënë Tahiri për "Radion Evropa e Lirë".

Ai ka thënë se për shkak të prodhimit më të ulët vendorë, tregtarët edhe kanë importuar produkte bujqësore po me çmim më të

lartë se vitin e kaluar.

Kosova importon pjesën më të madhe të produkteve, qofshin ushqimore apo të tjera. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, në vitin 2022 vlera e mallrave të importuara ka qenë mbi 5.6 miliardë euro, ndërsa në periudhën janar-korrik të këtij viti janë importuar produkte në vlerë rreth 3.3 miliardë euro.

"Qeveria t'i ndihmojë qytetarët"

Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, thotë se ngritja e çmimeve të produkteve të konsumit të përditshëm paralajmëron rritjen potenciale të inflacionit. Sipas tij, Qeveria e Kosovës duhet të jetë e vëmendshme dhe të gjejë forma që t'i ndihmojë qytetarët, përfshirë edhe prodhuesit. "Për shkak të inflacionit dhe rritjes së

çmimeve ka humbur vlera e parasë. Qeveria duhet ta mendojë mënyrën se si të rritet vlera e parasë në mënyrë që te qytetari të mos vërehet mungesa e ndonjë artikulli. Shportën që e ka blerë vitin e kaluar 500 euro - po them në mënyrë hipotetike - sivjet ta blejë me 600 euro, por me një ndihmesë në formën e rritjes së pagës, subvencionit të përkohshëm...", ka thënë Rafuna.

Paga mesatare në Kosovë është 520 euro, ndërsa minimalja sillet nga 130 deri në 170 euro. Në gushtin e vitit 2022 inflacioni në Kosovë ka qenë 13 për qind, ndërsa gushtin e kaluar ishte 3.2 për qind.

Rafuna ka thënë se nëse qeveria nuk mund të sigurojë rritje pagash ose subvencione për qytetarët, atëherë mund ta reduktojë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar për një gamë të gjerë të produkteve esenciale. Sipas tij, qeveria e ka të pamundur të ndikojë në çmimet në treg për shkak të ekonomisë së tregut të lirë. Projektligji për Çmimet Tavan, i hartuar nga Qeveria e Kosovës tetorin e vitit të kaluar, nuk është mbështetur nga partitë opozitare. "Radio Evropa e Lirë" e ka pyetur Qeverinë e Kosovës nëse ka mundësi të ndërmarrë ndonjë masë për zbutjen e inflacionit dhe efektit të ngritjes së çmimeve të produkteve esenciale, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk ka marrë përgjigje. Me qëllim që t'ua lehtësojë përballimin e inflacionit, qeveria gjatë vitit të kaluar ka ndarë disa herë shtesa për kategori të ndryshme sociale.

AAK-ja inicion seancë të jashtëzakonshme për koeficientin e pagave

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka iniciuar seancë të jashtëzakonshme në të cilën do të diskutohet Ligji për Paga.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, në një konferencë për medie të mërkurën, ka bërë me dije se janë duke i mbledhur nënshkrimet për të ftuar një debat parlamen-

tar, ku do të kërkohet që të ketë rritje të koeficientit nga 105 në 129.

Tahiri ka përmendur edhe institucionet që, sipas tij, janë dëmtuar nga Ligji për Paga, derisa ka specifikuar Policinë e Kosovës. "A mund të besoni që rreth 900 punëtorë civilë në Policinë e Kosovës, prej tyre 600 kanë zvogëlim të pagave. Pra, janë rreth 900

punëtorë në administratën civile në polici, ku rreth 600 kanë zvogëlim të pagave. A mund të besoni që gradat prej majorit, pra policët në shërbim, prej gradës major e deri te generali, te drejtori i policisë, kanë zvogëlim të pagës prej 120 deri në 600 euro?", ka thënë Tahiri, duke kërkuar nga qeveria ta rrisë koeficientin për paga nga 105 në 129.



FJALA E NJËRIT NGA THEMELUESIT E UÇK-SË, NAIT HASANI NË ZBULIMIN E OBELISKUT TË PJESËMARRËSVE TË PARË TË AKSIONIT TË ARMATOSUR NË GËRLICË TË FERIZAJT

Obelisku në Gërlicë dëshmon historinë e luftës së UÇK-së



*E nderuara familja e Rexhep Bislimit,
Të nderuar të pranishëm,
Të nderuar familje të dëshmorëve,
invalidëve dhe veteranëve të luftës
së UÇK-së,
Të nderuar pjesëmarrës të aksionit
të parë të armatosur: Ferat Shala,
Afrim Nuha, Idriz Hajdari dhe
dëshmori e Heroi i Kosovës Rexhep
Bislimi.*

Sa më larg në vite tëngjarjeve të zhvilluara të asaj kohe të luftës sonë për çlirim, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, aq më të rëndësishme po vlerësohen e do të vlerësohet lufta jonë, guximi, vendosmëria, dhe largpamësia e veprimit ushtarak të zgjidhjes së çështjes së Kosovës me luftë të armatosur për çlirimin dhe lirinë e Kosovës.

Nga sot kanë kaluar shumë vite nga dita e aksionit të përgjithshëm të armatosur në gjithë Kosovën, por kjo ditë tregon seriozitetin e luftës sonë, vendosmërinë e djemve tanë, për të kapur armët dhe për të luftuar e fituar lirinë dhe çliruar Kosovën.

Djemtë si Rexha (Rexhep Bislimi), Veziri tashmë dëshmorë e heronj



Ky obelisk u ngrit në përkujtim të aksionit gueril të UÇK-së, të datës 12 shtator 1997, kundër postbllokut policor famëkeq serb në Gërlicë.

Njësi i UÇK-së i udhëhequr nga Rexhep Bislimi, hero i Kombit, me urdhër të shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, me sukses të plotë e kreu aksionin e parë të armatosur në rajonin e Ferizajit me rrethinë.

Në këtë aksion morën pjesë:
Rexhep Bislimi - (Ferizaj)
Afrim Nuha - (Loshkobare, Ferizaj)
Ferat Shala - (Vuqak, Drenas)
Idriz Hajdari - (Dobroshec, Drenas)

This obelisk was erected in commemoration of the KLA guerrilla action on September 12, 1997, against the infamous Serbian police checkpoint in Gërlica.

The KLA unit, led by Rexhep Bislimi, Hero of the Nation, upon the order of the KLA General Staff, with complete success conducted the first armed action in the region of Ferizaj and its surroundings.

The following participated in this action:
Rexhep Bislimi - (Ferizaj)
Afrim Nuha - (Loshkobare, Ferizaj)
Ferat Shala - (Vuqak, Drenas)
Idriz Hajdari - (Dobroshec, Drenas)

të Kosovës dhe Xhaviti veteran tashmë i ndjerë dhe të gjallët e atyre betejave të luftës sonë heroike që vendit e popullit tonë dhanë lirinë, çlirimin, e popullit ja kthyen krenarinë, dinjitetin dhe na bënë të nderuar e të vlerësuar mes kombeve që e duan dhe e mbrojnë lirinë e fituar me gjak, por që sot fëmijët tanë në Kosovë gëzojnë këtë liri, të fituar nga heronjtë tanë të gjallë që shpallën pavarësinë dhe ndërtuan shtetin.

Lirinë tonë të fituar në betejatëpërgjakshme tashme pas njëzet viteve jemi duke luftuar me mbrojtje lirinë tonë të fituar me mund, vuajtje e burgje dhe sakrificë dhe gjak te brezave për liri në gjykatën speciale në Hagë. Gjykatë e krijuar padrejtësisht e fabrikuar me akuzat e Serbisë dhe presionin ndërkombëtar.

Kjo prokurori na çuan "Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale", ashtu e ka parafrazua në pikën e 35-të ku të gjithë luftëtarët janë "Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale", nga Shtabi i Përgjithshëm deri te ushtari i fundit dhe qeveria e



përkohshme e dalë nga lufta jonë e UÇK-së, këtë e dëshmon pika e aktakuzës që është tashmë publike. Pra nëse ne nuk e mbrojmë luftën tonë si veteran si luftëtar si shqiptar, ata gjykata do te përpiqet që luftës sonë t'ia ndërroj karakterin e luftës çlirimtare me ndihmën e Serbisë. Kurse bisedime me Serbin që sa vite janë duke u zhvilluar e dëshmojnë lojrat politike kinse për normalizim e bëjnë dhe më të rëndësishme luftën tonë për liri.

Sot shoqëria jonë akoma jeton me iluzione duke mos e vlerësuar luftën e djemve tanë, duke mos i vlerësuar të gjallët, veteranet e asaj lufte për çlirim e liri të Kosovës dhe një pjesë mendon se liria na ka ardhur dhuratë nga të huajt.

Liria jonë ka ardhur si rezultat ipërpjekjeve shekullore të gjyshërve, prindërve dhe djemve tanë dhe pa luftën tone, pa gjakun e dëshmorëve dhe vazhdimin e luftës nga këta të gjallët qe sot janë veteran te asaj lufte dhe te atyre betejave, Kosova do te ishte akoma e pushtuar dhe nën Serbi.

Dhe pas kaq viteve djemtë tanë, drejtuesit e luftës përballen në gjykata me padrejtësinë dhe absurditetin e saj, duke na bërë bashkë si "Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale". Na kemi luftuar kundër Serbisë me çliruar Kosovën me të gjitha mjetet e mundshme.

Sot duke urrikthyer në kohë kanë kaluar rreth 26 vite që kur e njoha Rexhën, Rexhep Bislimin. Ato ditët kujtoj si sot dhe më rrinë në kujtesën time. Atë e takova këtu në Ferizaj. Atë e pash këtu në këtë qytet. E pash dhe e gjeta këtu tek ju, në gjendje gatishmërie në mbrojtje të idealeve të lirisë, i



gatshëm të përballim me sfidat e kohës në mbrojtjen e çështjes së Kosovës, i gatshëm të merr përgjegjësi mbi vete për luftën, për çlirimin e Kosovës nga Serbia, i gatshëm në çdo pikëpamje fizike e psikike që të lufton, në luftën tonë, liri a vdekje.

Për këto situata e sfida politike e ushtarake, Rexha ishte pjekur që me kohë. Që nga koha e rinisë së tij, që nga demonstratat e viteve '81, '90, që nga protestat e ndryshme që zhvilloheshin në Kosovë, që nga arrestimi i tij politik viteve të tetëdhjeta dhe sidomos ai, Rexha ishte pjekur e përgatitur politikisht në idealet e lirisë nga Ekrem Jashari, baca Ekrem njeriu që i dha frymë e shpirt këtij vendi, që ia kushtojdijën dhe jetën atdheut dhe Kosovës, që dha pasurinë e tij për lirinë Kosovës, po që më së shumti i dha zjarr luftës për liri, që i dha shpirt e zjarr Ferizajt për çlirim nga okupimi shekullor serb, që me punën e tij, me angazhimet e tij jo vetëm në Ferizaj e Kosovë, po edhe në Maqedoni, Maltë Zi dhe Shqipëri të bacës Ekrem dhe nën kujdesin e tij e në bashkëpunim të ngushtë Rexha e Vezir Jashari me Xhavit Gashin me bacën Ekrem u bënë dhe njerëzit e parë në Ferizaj rrethinë që e fuqizuan i dhanë gjak e shpirt Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në këtë frymë lirie në fillim të vitit nëntëdhjetë e gjashtë e gjeta te Rexhë shokë Ferizaj të gatshëm të kapë Pushkën e Lirisë për çlirimin e Kosovës nga Serbia.

Në këtë takim erdhëm së bashku me gjeneral Rexhep Selimin, tashmë ai po gjykohej në Hagë, për luftën, për UÇK-në, me porosi të bacës Ekrem.

Atë pasdite pranvera e takuam te

shtëpia Rexhen aty ku na priste sipas porosisë e marrëveshjes me bacën Ekrem. Atë ditë folëm shkurt sa për njohje dhe e lamë takimin. Po ditën tjetër të takimit folëm për çdo gjë, folëm për UÇK-në, folëm për angazhimet tona, folëm për aksionet tona, folëm për veprimet tona, që duhen marrë kundër policisë e makinerisë policore e ushtarake serbe, folëm për përgatitjet që duhet bërë, folëm për jetën tonë politike dhe gjendjen tonë si shqiptarë në Kosovë gjendemi dhe u dakorduam sevetëm lufta jonë mund të na shpëtoj nga kjo gjendje, vuajtje e mjerimi dhe pasigurie e tmerrit, lemerie e frike ku ishte e katandisur Kosova, në atë kohë, nën regjimin e hekurit të Millosheviqit dhe të politikës së pritjes, politikës pacifiste, që ishte mbyllur me frikën vete e që priste çdo gjë që mund të vijë nga miqtë pa bërë gjë vetë për lirinë, ku në këtë gjendje politike fatkeqësisht atë herë kishin ra edhe disa shokë tanë, bashkëvuajtës nëpër burgjet serbe, të cilët kishin humb shpresën e besimin në vete, në rininë tonë, në fuqinë tonë si popull që mund të luftoj për lirinë e vendit.

Po Rexha në këtë vorbull politike nuk kishte humbë shpresën e as besimin në vete, as në popull, as në rininë, po ai Rexha me shokë pristeme shpresë vendimet e LPK-së, për veprime ushtarake do të mobilizojnë shqiptarët. Dhe ato vendime të LPK-së te njerëzit lirinë që ishin në Kosovë dhe te njerëzit e pakënaqur që kishte shumë në Kosovë u krijuan grupet dhe njësitet e armatosura ushtarake të cilat me përpjekje mbinjerëzore u bashkuan në një organizëm të vetëm ushtarak në

Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Kurse lajmin se UÇK-ja është ushtri e jonë shqiptare, Rexha e priti me gëzim e besim, me shpresë dhe emocion në vete që shprehej në sy qëi shkëlqenin, sepse shumë kishin hapëpropaganda senëveprimet e UÇK-së, janë serbët, që po i bëjnë këto veprime për të dëmtuar imazhin e politikës pacifistete të Kosovës.

Ky lajm se unë dhe ne jemi UÇK, ishte një lajm që përpiu Rexha dhe me fjalët e tij të thëna në ato qaste ishin aq të forta, aq njerëzorë, aq lirinëdashëse, aq burrërore, unë jam ushtar i UÇK-së, tha me plotë gojë e me shpirt, nga sot dhe jam gatshëm ta jap jetën për çlirimin e Kosovës dhe nëse është nevoja për atdhe edhe familjen e sakrifikoj për këtë vend, për lirinë e Kosovës dhe shtrëngoi fort në dorë, pushkën e UÇK-së që i dhashë unë, pushkën e lirisë, qëkrismat e saj ia futi tmerrin përgjithmonë Serbisë dhe me armët tona e larguam makinerinë gjakatare serbe me forcë nga Kosova.

Ndërsa ne sot e përurojmë Obeliskun e këtij aksioni ne pikën me tërëndësishme të kohës ku rrinin policia Serbe, pikë që ka tmerruar me dhunën e terrorin qytarët e kësaj ane dhe të gjithë Kosovës, aksion që ju ka treguar se Kosova ka djem e vajza që dalin zot vendit dhe japin jetë për këtë vend dhe për lirinë e këtij trolli.

Ky obelisk me emrat e heronjve të gjallë: Ferat Shala, Afrim Nuha dhe Idriz Hajdari me heroin e Kosovës, Rexhep Bislimi do të jetë një shenjë në kohë i luftës sonë dhe do tua tregoj brezave për betejat dhe ngjarjet e luftës sonë shekullore për liri.



Tashmë është koha që në shkollat tona të mësojnë nxënësit për historinë dhe betejat e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të mësojnë dhe për të gjallët për ata që ja kthyen dinjitetin e krenarinë këtij vendi e Kosovës. Të mësojnë për heronjtë, për dëshmorët, për

luftën tonë çlirimtare dhe për këta luftëtar të gjallë që sot si këtu dhe në Hagë janë në mbrojtje të lirisë sonë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Respekt e nderime luftës së UÇK-së, Respekt e veteraneve e invalidëve të UÇK-së që gjytmtyrët lanë neper

fushëbeteja për liri. Lavdi dëshmorëve që gjaku i tyre u be dritë në altarin e lirisë! Nderime aksionisteve të parë në këtë anë në fillet luftës sonë! Lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që na dha emër e dinjitet e që sot në Kosovë, falë kësaj ushtrie jemi shqiptar!





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kryeministri Kurti: Do ta ndërtojmë stadiumin nacional



PRISHTINË, 13 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në mbledhjen e radhës të Qeverisë së Kosovës të mbajtur dje, ka thënë se në vazhden e ndërtimit të infrastrukturës sportive për organizimin e Lojërave Mesdhetare në vitin 2030, është paraparë edhe ndërtimi i stadiumit nacional. Sipas shefit të ekzekutivit, organizimi i Lojërave Mesdhetare është ngjarja më e madhe ndërkombëtare në historinë e vendit tonë. “Me mobilizimin e të gjithë kabinetit qeveritar dhe në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës, i kemi sjellë Republikës së Kosovës mundësinë për organizimin e ngjarjes më të madhe ndërkombëtare në historinë e vendit tonë. Koncepti me të cilin e

kemi shënuar këtë fitore është shumë i veçantë dhe në linjë me vizionin e qeverisë sonë për zhvillimin e sportit në vend. Në partneritet me Shqipërinë po shënojmë edhe herën e parë që kjo ngjarje të organizohet në një shtet që nuk ka dalje në det”, ka thënë Kurti.

Kryeministri Kurti ka bërë me dije se në programin për ndërtimin e infrastrukturës janë të parapara të ndërtohen e rinovohen 24 objekte sportive, si stadiumi nacional, pishina olimpik, poligoni i shenjtërisë e të tjera. “Përmirësimi dhe ngritja e infrastrukturës sportive fizike është në qendër të aplikimit dhe fitores së Republikës së Kosovës për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. Numri total i objekteve sportive të cilat

përfshihen në konceptin fillestar të këtij projekti është 24. Katër objekte sportive do të rinovohen, duke përfshirë edhe Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve, katër ndërtime të reja që përfshijnë stadiumin nacional, kompleksin e pishinave olimpikë, kompleksin e tenisit dhe poligonin e shenjtërisë. Pesë investime infrastrukturore të përkohshme dhe pesë projekte të tjera të cilat janë në ndërtim apo përfundim e sipër, në mesin e të cilave edhe stadiumi ‘Adem Jashari’ në Mitrovicë dhe stadiumi i qytetit të Gjilanit”, ka deklaruar Kurti.

Të drejtën për organizimin e Lojërave Mesdhetare Kosova e fitoi më 8 shtator në mbledhjen e zakonshme të Asamblesë së Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare.

SHKURT

Muhamet Rama ia sjell dy medalje të arta Kosovës nga Izmiri

Atleti veteran Muhamet Rama ia ka sjellë Kosovës dy medalje të arta nga gara “Balkan Masters Athletic”, e cila këtë vit është mbajtur në Izmir të Turqisë. Kompania “Eurokoha” ka qenë sponsore gjenerale për pjesëmarrjen e atletit veteran i cili e ka përfaqësuar Kosovën. Rama ka fituar vendin e parë në garat e vrapimit 800 metra dhe një medalje tjetër në garat 400 metra, duke lënë pas shumë shtete të tjera të Ballkanit. “Eurokoha” është krenare që ka mbështetur pjesëmarrjen e Ramës, i cili, edhe pse në moshën 79-vjeçare, tash e 21 vjet është duke u shpërblyer me medalje në çdo garë nëpër Evropë.

Shala rikthehet te Erzurumspor

Herolind Shala është rikthyer në futbollin turk. Mesfushori kosovar qëndroi për dy vjet te skuadra turke Erzurumspor, por u largua në qershor të këtij viti. Përkundër se ishte në bisedime me disa klube të tjera, ai nuk arriti marrëveshje dhe ka vendosur të rikthehet sërish në Erzurum. Në fakt, klubi turk ka këmbëngulur për rikthimin e tij që nga muaji qershor, por vetëm tani e ka bindur atë. Shala është paraqitur tani te skuadra turke dhe ka nënshkruar kontratë njëvjeçare. Ndeshjen e parë me fanellën e Erzurumit për sezonin e ri Shala pritet ta zhvillojë në fundjavë ndaj Altayt.

Goli i Asanit në mesin e katër më të mirëve për xhiron e gjashtë të kualifikimeve për ‘Euro 2024’

Ylli i Kombëtares së Shqipërisë, Jasir Asani, shënoi një nga golat më të bukur ndonjëherë nga një lojtar që bart fanellën kuqezi. Tani UEFA ka treguar katër golat më të mirë të xhiros së gjashtë, ku mund të votohet për t’u zgjedhur më i miri. Asani me golin në minutën e 37 i dhuroi Shqipërisë epërsinë 1-0 ndaj Polonisë, në ndeshjen që në fund u fitua me rezultat 2-0, pas golit të Mirlind Dakut. Kuqezinjtë tani janë shumë afër kualifikimit në një tjetër Kampionat Evropian. 28-vjeçari është në garë me Joao Felixin e Portugalisë, Maxim Samorodov të Kazakistanit dhe Leandro Trossard të Belgjikës. Duke parë nivelin e vështirësisë për t’u ekzekutuar një gjuajtje e tillë, edhe pse të gjithë këta gola ishin të bukur, Asani nuk do të duhet ta kishte problem ta fitonte këtë sfidë.

Presidenti i Dritës: Pse mos të ftohen Edvin Kuç dhe Rron Broja?

Gjilan, 13 shtator - Përfaqësuesja e Kosovës ka pësuar humbje nga Rumania në udhëtim me rezultat 2-0. Pas gjashtë ndeshjeve “Dardanët” kanë katër barazime dhe dy disfata duke mos shijuar ende fitoren në këtë

kampanjë kualifikuese. Kritikkat nuk kanë munguar kurrë për listën e futbollistëve të ftuar, pasi kërkohet që të shikohen futbollistët edhe nga elita e futbollit të Kosovës. Presidenti i Dritës, Valon Murseli, në “Facebook” ka

pyetur pse nuk ftohen në përfaqësuese dy mesfushorët më të mirët në kampionat, Rron Broja dhe Edvin Kuç. “Rron Broja dhe Edvin Kuç po shkëlqejnë që sa kohë në kampionatin tonë dhe garat evropiane. Megjithatë, ata nuk ftohen

nga Përfaqësuesja e Kosovës dhe në atë pozitë tani e sa vite luajnë mbrojtësit”, ka shkruar Murseli. “Kanë mbetur edhe katër ndeshje. Duhet t’u jepet hapësirë edhe futbollistëve nga Superliga”, ka shtuar Murseli.



Khaka: Festova me gisht sepse më pëlqen të provokoj

Cyrih, 13 shtator - Kapitani i Zvicrës, Granit Xhaka, ka folur pas fitores kundër Andorrës (3-0). Mesfushori shqiptar shënoi një gol dhe dhuroi një asistim. Xhaka ka thënë se duhet të merrnin gjashtë pikë

në këto dy ndeshje (Kosovës dhe Andorrës), por tani duhet të mbyllet kualifikimi sa më parë. "Shpresonim të merrnim gjashtë pikë në shtator, në fund morëm vetëm katër, por ende jemi në

krye dhe më e rëndësishmja është të përfundojmë me kualifikim", ka thënë Xhaka. Zvicra ndryshoi sistem duke luajtur 3-4-3, që i pëlqeu Xhakës. "Kemi lojtarë për të evoluar kështu, mund të

vazhdojmë me dy sisteme, duke përfshirë edhe këtë", ka shtuar Xhaka. Në fund ai u pyet edhe për festën me gishtin në hunë. Ai u përgjigj duke qeshur: "Më pëlqen të provokoj".



Federata rumune dënon sjelljen e huliganëve të vet: Politika nuk ka vend në sport



BUKURESHTI, 13 GUSHT - Federata e Futbollit e Rumanisë ka dënuar sjelljen e huliganëve të vet në ndeshjen ndaj Kosovës, të cilët kanë shpalosur banderola nacionaliste dhe kanë bërë thirrje "Kosova është Serbi". Ndeshja në mes të Rumanisë dhe Kosovës u ndërpre për rreth 50 minuta para se futbollistët të rikthehen në fushë. Ishin futbollistët "dardanë" që i bënë të qartë gjyqtarit kryesor se pa u ndaluar thirrjet raciste dhe nacionaliste si dhe pa u larguar banderolat nuk do të luanin. Ndërkohë ka reaguar edhe Federata e Futbollit e Rumanisë (FRF), që ka dënuar sjelljen e huliganëve, ndërsa e ka falënderuar pjesën tjetër të

mbështetësve për përkrahjen. "Federata e Futbollit e Rumanisë fuqishëm dënon sjelljen e papërgjegjshme të grupit të shikuesve që çoi në ndërprerjen e ndeshjes së mbrëmshme ndërmjet Rumanisë dhe Kosovës. Fillimisht, ritheksojmë parimin me të cilin qeveriset futbollit në Rumani, përkatësisht mosndërhyrja e politikës në aktin sportiv. Revizionizmi nuk pranohet në futboll dhe FRF dënon ashpër mesazhet provokuese të natyrës politike, ideologjike, fetare apo fyese, të cilat janë kategorikisht të ndaluara në stadione", thuhet në reagimin e Federatës rumune. "Të

gjitha këto u regjistruan në tribunat e Arenës Kombëtare nga një grup i vogël i të ashtuquajturve mbështetës, duke ndikuar në rrjedhën normale të ndeshjes. Aktet e huliganizmit u hodhën poshtë nga pjesa tjetër e spektatorëve në stadium, të cilët u privuan nga një spektakël futbollit që dëshironin dhe për të cilin paguan një biletë. FRF shpreh keqardhjen për përvojën e keqe të përjetuar nga shumica e shikuesve dhe i falënderon ata për mbështetjen fantastike që ua ofruan 'trengjyreshve' në pjesën e dytë të ndeshjes, duke i çuar në fitore dramatike!", thuhet në deklaratën e FRF-s.

Simona Halep përjashtohet nga tenisi për katër vjet

CONSTANTA, 13 GUSHT - Ish-numri një në tenis dhe dy herë fituesja e garave Grand Slam, Simona Halep, është përjashtuar nga ky sport për katër vjet për shkak të dy shkeljeve të dopingut. Halep, 31 vjeç nga Rumania, është deklaruar e pafajshme për dy rastet e ndara të dopingut dhe është zotuar se do ta apelojë çështjen në Gjykatën e Arbitrazhit për Sport (CAS). Agjencia Ndërkombëtare për Integritet në Tenis (ITIA) njoftoi për pezullimin më 12 shtator, pasi vendimi u mor nga një tribunal i pavarur. Halep edhe në të kaluarën ishte pezulluar nga tenisi profesional pasi kishte rezultuar pozitive për roxadustat më 2022 në garën US Open.

ITIA tha se Halep personalisht kishte dëshmuar gjatë seancave dëgjimore të tribunalit që u mbajtën në fund të qershorit. Ajo u gjet se ka shkelur Programin Anti-Doping të Tenisit (TADP) në dy raste më 2022. Hapel gjatë



karrierës së saj ka fituar në Wimbledon dhe në Franch Open. Më 2019 ajo u bë rumunia e parë që u radhit e para në listën e tenisteve më të mira në botë. Pas njoftimit të ITIA-s, Halep, sipas Reuters, ka deklaruar se ajo refuzon "ta pranojë vendimin për ndalesën prej katër vjetësh".

"Synoj ta apeloj vendimin në Gjykatën e Arbitrazhit për Sport dhe t'i ndjek të gjitha rrugët ligjore kundër kompanisë që prodhon suplementin në fjalë [roxadustat]", citohet të ketë thënë ajo. Nëse mbetet në fuqi, ndalesa ndaj tenistes rumune do të përfundojë në fillim të tetorit të vitit 2026.

SHKURT

Vdes në moshën 42-vjeçare ish-basketbollisti i NBA-s

Ish-basketbollisti i NBA-s, Brandon Hunter, ka vdekur në moshën 42-vjeçare. Për vdekjen e tij ka njoftuar Jeff Boals, trajner i Ohio Bobcats. "U prehtë në paqe një madhështor i Bobcat! Na la shumë herët", ka shkruar Boals në "Instagram". Hunteri në NBA kishte luajtur për Boston Celtics dhe Orlando Magic, ndërkaq më vonë kishte luajtur edhe në Evropë.

Kvaratskhelia shihet si zëvendësues i Salahut në Liverpool

Merkato është mbyllur prej më shumë se shtatë ditësh, por kjo nuk mjafton për t'i shuar zërat në lidhje me operacionet e ardhshme. Madje në orët e fundit një lajm nga Anglia po frikëson tifozët e Napolit. Një lajm që ka lidhje me Kвича Kvaratskhelia, që ka përfunduar në shënjestrën e një klubi të madh. Sipas "The Atjeltic", në fakt, në rast se Salah do të vendosë të largohet nga Liverpooli, "Të Kuqtë" do të hidheshin në sulm për sulmuesin e Napolit. Gjeorgjiani ka qenë zbulimi i sezonit të kaluar në Serinë A dhe një nga arsyet kryesore që ndihmuan Napolin ta fitonte titullin.

Handanoviçi pensionohet nga futbollit

Portieri sloven Samir Handanoviçi ka vendosur të largohet përfundimisht nga futbollit i luajtur. Këtë vendim e ka marrë pasi nuk ka marrë oferta të kënaqshme pas përfundimit të aventurës së tij tek Interi. Sipas "Il Giornale", Handanoviçi do të qëndrojë te zikaltrit në një rol bashkëpunëtori, ndoshta si një zbulues apo trajnues portierësh. Handanoviçi ka qenë një nga portierët më të mirë të 10-vjeçarit të fundit në Itali dhe jo vetëm. Me Interin, sloveni ka luajtur 455 ndeshje në total, ku e ka mbajtur portën të paprekur në 166 ndeshje.

Xavi, afër nënshkrimit të marrëveshjes së re me Barçën

Xavi Hernandez së shpejti pritet ta nënshkruajë kontratën e re me klubin e Barcelonës. Sipas ekspertit të transferimeve, Fabrizio Romano, drejtori sportiv i Barcelonës ka konfirmuar lajmin për kontratën e re të Xavit të Barcelona. "Xavi e meriton kontratën e re. Ajo do të bëhet së shpejti. Ne vërtet i besojmë atij si trajner për projektin tonë", u shpreh Deco. Xavi është trajner i katalanësve që nga viti 2021, ku erdhi nga AL-Saddi.

Voller: Brenda tri javësh do të paraqitet trajneri i ri i Gjermanisë

Gjermania shkarkoi trajnerin Hansi Flick pas rezultateve të dobëta me kombëtaren, ku në ndeshjen e fundit miqësore u mund thellë 1-4 nga Japonia. Trajneri i përkohshëm, Rudi Voller, i cili është edhe drejtori sportiv, deklaroi se brenda tri javësh përfaqësuesja gjermane do ta ketë trajnerin e ri. "Tekniku vendës do të ishte i përkryer, marrë në konsideratë që do të luajmë Evropianin përballë publikut tonë. Detyra jonë kryesore është gjetja e trajnerit sa më shpejt. E shumta në harkun e tri javëve do të jetë e përfunduar si çështje. Ndryshimi i frymës mbetet jetik. Sigurisht që kemi diskutuar disa emra", ka theksuar ish-futbollisti i Gjermanisë në periudhën 1982-1994.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 971 /1
Dt: 13.09.2023

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017, Udhëzimi Administrativ 05/2021 Vendimi (MASHTI) nr. 326/01B të dt. 28.07.2022 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira dhe zëvendësim në Qendrën e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, dhe Qendrën e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2023/2024

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vend i lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë	Malishevë	Një (1) mësimdhënës/e për profilin e TIK-ut (20 orë mësimore);	Zëvendësim deri në kthim e mësimdhënës nga pushimi i lehonisë
SHML	Qendra e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi”, në Prishtinë	Prishtina	Dy (1) Instruktor /e për modulet profesionale të profilit “Floktari”, me nga 20 orë;	Vend i lirë
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) Instruktor /e për të profilit “Teknik i Optikës”, 19 orë;	Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillt me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrë të duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale përkatës sipas UA (MASHTI), niveli i 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës në arsim (nëse ka);
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor:

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale përkatës sipas UA (MASHTI), niveli i 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lart;
- Për modulet e praktikës profesionale të profilit “Floktari”, përparësi kanë kandidatët me përgatitje/ kualifikim Bachelor, niveli i V ose ekuivalent, me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në fushën përkatëse;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, dhe Qendrën e Kompetencës në Ferizaj.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “CyberAgent” Sh.P.K. me pronar Fetie Hyseni Zahiri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811945750 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “CyberAgent” D.O.O. Fetie Hyseni Zahiri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811945750 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “CyberAgent” L.L.C Fetie Hyseni Zahiri, has come to the decision to quit its business: 811945750 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Shpallje për gazetë

Ofertë për shitjen e patundshmërisë

Resnik (Besnik) Xharra, me adresë banimi në Prizren rr."Shaip Spahiu" nr.22, është bashkëpronar të patundshmërisë, me sa vijon:

-me pjesën prej 1/2 e pjesës ideale (rreth 435.5 m2) të ngatrës kadastrale nr.P-71813076-03908-0, në vendin e quajtur "Rasad te-Rid", me kulturë bujqësore – livadh i kl.8, në sipërfaqe të përgjithshme prej 871 m2, ZK Sredskë,

-me pjesën prej 1/2 e pjesës ideale (rreth 193 m2) të ngatrës kadastrale nr.P-71813076-04273-0, në vendin e quajtur "Ravanj-Brestovi", me kulturë bujqësore – livadh i kl.7, në sipërfaqe të përgjithshme prej 386 m2, ZK Sredskë,

-me pjesën prej 1/2 e pjesës ideale (rreth 86.5 m2) të ngatrës kadastrale nr.P-71813076-04274-0, në vendin e quajtur "Ravanj-Brestovi", me kulturë tokë pyjore – mal i kl.5, në sipërfaqe të përgjithshme prej 173 m2, ZK Sredskë,

-me pjesën prej 1/4 e pjesës ideale (rreth 115.5 m2) të ngatrës kadastrale nr.P-71813076-04303-0, në vendin e quajtur "Ravanj-Krajqi", me kulturë Tokë ndërtimore – shtëpi-ndërtesë dhe oborr, në sipërfaqe të përgjithshme prej 462 m2, ZK Sredskë,

-me pjesën prej 1/4 e pjesës ideale (rreth 21.25 m2) të ngatrës kadastrale nr.P-71813076-04314-0, në vendin e quajtur "Ravanj-Milovanovo", me kulturë bujqësore – pemishte e kl.6, në sipërfaqe të përgjithshme prej 85 m2, ZK Sredskë,

-me pjesën prej 1/2 e pjesës ideale (rreth 178.5 m2) të ngatrës kadastrale nr.P-71813076-03887-0, në vendin e quajtur "Ravanj-Brestovi", me kulturë tokë pyjore – mal i kl.5, në sipërfaqe të përgjithshme prej 357 m2, ZK Sredskë.

Shitësi **Resnik (Besnik) Xharra** nga pjesa e vet ideale të patundshmërisë P-71813076-03908-0, P-71813076-04273-0, P-71813076-04274-0, P-71813076-04303-0, P-71813076-04314-0, dhe P-71813076-03887-0, oferton për shitje sipërfaqen e përgjithshme prej 435.5 m2 + 193 m2 + 86.5 m2 + 115.5 m2 + 21.25 m2 + 178.5 m2 = 837.25 m2 të patundshmërisë me të dhënat si më lart, në shumën prej 500 € 1 ari, gjegjësisht 837.25 € x 500 € = 4.187 €, përkatësisht në shumën e përgjithshme prej 4.187 € (me shkronja: Katërmijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë euro).

Prizren, 11.09.2023

Ofertuesi,
Resnik (Besnik) Xharra

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Genti-EL SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330330738.

Elba Kos SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 811556177.

Lendita Elshani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Xheladin Deda".

Ahmet Musliu shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

Ylber Sadikaj shpall të pavlefshme diplomën SHFMU "Asim Aliqaj" Poslishtë.

Denat Memaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Dëshmorët e Zhurit" Zhur.

Xhemal Sagdati shpall të pavlefshme 1 dëftesë si dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

Elton Bytyqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme Ekonomike' Kadri Kusari".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

